Në kuadër të organizimit të këtij festivali, nga Republika e Turqisë do të marrin pjesë në programin artistik një ekip prej 4 artistësh: Semih Ersoy, Eray Karani, Melih Türksever dhe Ferhat Yıldız. Për sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në këtë aktivitet, janë krijuar shpenzime për transportin rrugor vajtje-ardhje, të cilat janë realizuar përmes kompanisë A.T. ÖMER TRAVEL.

Bazuar në faturën nr. 2648N5, të datës 01.07.2026, në vlerë prej 784.00 €, është kërkuar realizimi i pagesës për mbulimin e shpenzimeve të transportit për ekipin artistik të lartcekur.

Duke marrë parasysh rëndësinë e organizimit të Festivalit të Domates, promovimin e kulturës, bashkëpunimin me artistë nga jashtë vendit dhe obligimin për përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj operatorit ekonomik, është e nevojshme dhe e arsyeshme të bëhet pagesa e shumës prej 784.00 € në favor të kompanisë A.T. ÖMER TRAVEL.

Andaj, duke u bazuar në dokumentacionin përkatës financiar dhe administrativ, është nxjerrë ky vendim për lejimin e pagesës së faturës së lartcekur.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtoria përkatëse
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 172-26
Me 09/07-2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “ SUBVENCIONIMI I BUJQËVE, MJESHËRVE DHE GRAVE PËR FUQIZIM EKONOMIK PËRMES PAJISJEVE TË PUNËS”

- 1. Z. Labinot Muhaxheri-** Zyrtar i Lartë për buxhet dhe financa në Drejtorinë e Bujqësisë, Caktohet person përgjegjës nga njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit “ ***SUBVENCIONIMI I BUJQËVE, MJESHËRVE DHE GRAVE PËR FUQIZIM EKONOMIK PËRMES PAJISJEVE TË PUNËS***”
- 2.** Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
- 3. Obligohen-** personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
 - 3.1.** Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 171/26
Me 07.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa për Projektin BNS – Bio Natural Solution, Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD)- Republika e Maqedonisë së Veriut – Donacion i Bashkimit Evropian

Neni 1

Lejohet pagesa në kuadër të implementimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “BNS – Bio Natural Solution për menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbrojtjen e ujit në Komunitetin e Mamushës dhe Bogovinjes”, nr. 2026/490-184, dhe në përputhje me kontratën e grantit të nënshkruar ndërmjet palëve, të behet pagesa ndaj përfituesit Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD)- Republika e Maqedonisë së Veriut.

Neni 2

Pagesa bazohet në faturën nr. CB-01/2026, datë 08.06.2026, në shumën prej 7,800.00 EUR, e cila paraqet koston e parë të parashikuar për aktivitetet e projektit sipas planit të zbatimit dhe buxhetit të aprovuar të Shtojcës III të kontratës së grantit. Mjete financiare janë fonde të Bashkimit Evropian të alokuara sipas marrëveshjes së grantit dhe janë të dedikuara ekskluzivisht për realizimin e aktiviteteve të projektit. Mjetët janë të alokuara sipas bllokut kodues blloku kodues: 49/626/18014/31260/92273/0451, sipas ID së përfituesit TN307600MK me numr të zotimit 2026-104342, sipas llogarisë bankare MKO7240190122451898.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Shënim: Duke qenë se përfituesi është jashtë territorit të Republikës së Kosovës, pagesa do të realizohet përmes transferit ndërkombëtar bankar në përputhje me procedurat e aplikueshme financiare dhe rregullat e menaxhimit të fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe përmes sistemit të Thesarit dhe bankës përkatëse të shtetit përfitues.

Me këtë vendim njoftohet :

- z. Engin Taç, Zyrtar i Lartë për Financa – Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- z. Hysni Ahmeti, Menaxher i Projektit BNS;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar;
- Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD);
- Komuna e Bogovinjes-Republika e Maqedonisë së Veriut;
- SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës;
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 170/26
Me 07.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa për Projektin BNS – Bio Natural Solution, Komuna e Bogovinjes, Republika e Maqedonisë së Veriut – Donacion i Bashkimit Evropian

Neni 1

Lejohet pagesa në kuadër të implementimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “BNS – Bio Natural Solution për menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbrojtjen e ujit në Komunitet e Mamushës dhe Bogovinjes”, nr. 2026/490-184, dhe në përputhje me kontratën e grantit të nënshkruar ndërmjet palëve, të behet pagesë ndaj përfituesit Komuna e Bogovinjes.

Neni 2

Pagesa bazohet në faturën nr. B-01, datë 08.06.2026, në shumën prej 32,470.00 EUR, e cila paraqet koston e parë të parashikuar për aktivitetet e projektit sipas buxhetit të aprovuar në Shtojcën III të kontratës së grantit. Mjete financiare janë fonde të Bashkimit Evropian të alokuara sipas marrëveshjes së grantit dhe janë të dedikuara ekskluzivisht për realizimin e aktiviteteve të projektit. Mjetët janë të alokuara sipas bllokut kodues blloku kodues: 49/626/18014/31260/92273/0451, sipas ID së përfituesit TN307601MK me numr të zotimit 2026-104344, sipas llogarisë bankare 7050140959785A3.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Shënim: Duke qenë se përfituesi është jashtë territorit të Republikës së Kosovës, pagesa do të realizohet përmes transferit ndërkombëtar bankar në përputhje me procedurat e aplikueshme financiare dhe rregullat e menaxhimit të fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe përmes sistemit të Thesarit dhe bankës përkatëse të shtetit përfitues.

Me këtë vendim njoftohet :

- z. Engin Taç, Zyrtar i Lartë për Financa – Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- z. Hysni Ahmeti, Menaxher i Projektit BNS;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar;
- Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD);
- Komuna e Bogovinjes-Republika e Maqedonisë së Veriut;
- SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës;
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 169/26
Me 07.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa për Projektin BNS – Bio Natural Solution, SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës – Donacion i Bashkimit Evropian

Neni 1

Lejohet pagesa në kuadër të implementimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “BNS – Bio Natural Solution për menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbrojtjen e ujit në Komunitet e Mamushës dhe Bogovinjes”, nr. 2026/490-184, dhe në përputhje me kontratën e grantit të nënshkruar ndërmjet palëve, të behet pagesë ndaj përfituesit SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës.

Neni 2

Pagesa bazohet në faturën nr. SH-01, datë 08.06.2026, në shumën prej 7,800.00 EUR, e cila paraqet koston e parë të parashikuar për aktivitetet e projektit sipas buxhetit të aprovuar në Shtojcën III të kontratës së grantit. Mjete financiare janë fonde të Bashkimit Evropian të alokuara sipas marrëveshjes së grantit dhe janë të dedikuara ekskluzivisht për realizimin e aktiviteteve të projektit. Mjetët janë të alokuara sipas bllokut kodues bllokut kodues: 49/626/18014/31260/92273/0451, sipas ID së përfituesit 51007484 me numr të zotimit 2026-104339, sipas llogarisë bankare 1701016900026004.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Shënim: Pagesa do të realizohet brenda territorit të Republikës së Kosovës, në përputhje me procedurat e brendshme të menaxhimit financiar dhe rregullat e aplikueshme për ekzekutimin e pagesave dhe rregullat e menaxhimit të fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe përmes sistemit të Thesarit dhe bankës përfituese.

Me këtë vendim njoftohet :

- z. Engin Taç, Zyrtar i Lartë për Financa – Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- z. Hysni Ahmeti, Menaxher i Projektit BNS;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar;
- Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD);
- Komuna e Bogovinjes-Republika e Maqedonisë së Veriut;
- SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës;
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 168 /26
Me 07.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa për bashkëfinancim-çertifikimi i fermerëve nga Global G.A.P

Neni 1

Lejohet pagesa për Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar nga AgroDev Kosovo (Fondacioni për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës) dhe Kryetari i Komunës së Mamushës sipas protokollit 02 Nr.23-26 datë 21.05.2026.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë: përfituesi AgroDev- Fondacioni për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës, Nr.Unik i përfituesit 5200611-2, mjetet deponohen në xhirollogarin bankare 1110346382000120-PCB, sipas Numrit të Zotimit 2026-104334 në shumën prej 12,000.00€ sipas marrëveshjes/memorandumit.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim: Objektivat specifike të AgroDev Kosovo në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë: Të sigurojë që rreth 100 prodhues/fermerë të primeve në Komunën e Mamushës të çertifikohen sipas Global G.A.P Opsioni II (çertifikim në grup) për sezonin e eksportit 2026. Global G.A.P. është një standard ndërkombëtar për praktikën e mira bujqësore, i zhvilluar që synon të sigurojë prodhim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të gjurmueshëm. Ai përcakton kërkesa për sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, si dhe menaxhimin e përgjithshëm të fermës. Çertifikimi Global G.A.P. është bërë një kusht i rëndësishëm për qasje në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht në Bashkimin Evropian, duke ndihmuar fermerët të rrisin cilësinë e prodhimit dhe besueshmërinë ndaj blerësve. Ky çertifikim do të mundësojë hapjen e tregjeve të reja për fermerët e Mamushës, si dhe njëkohësisht stabilizimin e tregjeve ekzistuese përmes përputhjes gjithnjë e më të madhe me standardet e kërkuara të tregut. Të lehtësojë trajnimin e

fermerëve në praktikat e mira bujqësore, me qëllim arritjen e çertifikimit të kërkuar. Të lehtësojë zhvillimin e ekspertizës lokale, e cila do të jetë e disponueshme për të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme programet e çertifikimit, në mënyrë të pavarur dhe brenda kompanive që operojnë si pika grumbulluese në Mamushë. Të monitorojë performancën e çertifikimit dhe ndikimin e tij në stabilizimin dhe zgjerimin e tregut.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Bujqësisë;
- Agrodev Kosovo-Fondacioni për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës;
- Menaxheri i projektit për bashkëfinancim;
- Arkivi.



Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 167/26
Më: 06.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR 05/2020, për procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komitetiteve të përhershme dhe Komiteteve të tjera në Komunë, Vendimi për Themelimin e Komitetit për Komunitete me numër të Protokollit 01.Nr.07.02.2026 nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa e anëtarëve të përhershëm (të jashtëm) të Komitetit për Komunitete

Neni 1

Me këtë vendim lejohet kompensimi financiar për anëtarët e jashtëm të Komitetit për Komunitete të Komunës së Mamushës, të cilët janë zgjedhur nga Kuvendi Komunal me Vendimin nr. 01-07-26, datë 27.02.2026, dhe kanë marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Neni 2

Kompensimi sipas këtij vendimi u takon:

- z.Halim Sadiku – Kryesues i Komitetit për Komunitete;
- z.Fadil Sadikaj – Anëtar i Komitetit për Komunitete;
- znj.Gulizar Zogaj – Anëtare e Komitetit për Komunitete;
- znj.Hasime Shala – Anëtare e Komitetit për Komunitete.

Neni 3

Periudha e kompensimit, realizohet për pjesëmarrjen në mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbajtura më: 31.03.2026; 30.04.2026; 29.05.2026; dhe 30.06.2026. Lartësia e kompensimit për secilin muaj në të cilin është mbajtur mbledhja dhe është realizuar pjesëmarrja, përfituesve u njihet kompensim në shumën bruto prej 207.90€, që korrespondon me 30% të pagës bazë të anëtarit të Kuvendit Komunal të Komunës së Mamushës, ndërsa ekzekutimi përmes Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike (SIMFK) realizohet sipas llogaritjes ligjore të tatimeve dhe kontributeve, në shumën neto 197.50€.

Neni 4

Arsyetim për pagesë: Komiteti për Komunitete është komitet i përhershëm i Kuvendit Komunal, i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Anëtarët e përmendur në nenin 2 janë zgjedhur me vendim të Kuvendit Komunal dhe kanë ushtruar funksionin e tyre duke marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

Për anëtarët e jashtëm të komiteteve të përhershme, të cilët nuk janë të punësuar në sektorin publik, legjislacioni në fuqi nuk përcakton mënyrën konkrete të realizimit të kompensimit. Opinionet e dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme (DMZP) kanë karakter interpretues dhe nuk kanë fuqi detyruese, ndërsa nuk ofrojnë bazë konkrete ligjore dhe procedurale për ekzekutimin e këtyre pagesave.

Duke qenë se përfituesit kanë kryer detyrat e tyre në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal, Komuna e Mamushës, në cilësinë e Organizatës Buxhetore, konsideron se kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është obligim institucional që rrjedh nga ushtrimi i funksioneve të tyre në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal dhe legjislacionit në fuqi dhe e ka planifikuar dhe buxhetuar mjetet financiare për kompensimin e anëtarëve të komiteteve të përhershme në kuadër të buxhetit të miratuar për vitin fiskal 2026. Lidhur me mënyrën e realizimit të pagesës së anëtarëve të jashtëm kemi kërkuar që të procesohen në listë të pagave në kuadër të Kuvendit Komunal programi 16914, anëtarët që ushtrojnë funksione në komitetet e përhershme të tij edhe pse janë anëtar të zgjedhur nga jashtë dhe në planifikim buxhetor është e planifikuar shtesa dhe kompenzime tjera për vitin 2026 dhe kjo shtesë që neve kemi kërkuar të paguhet jo mbi pagën bazë të një kuvendari/asambleisti por për shtesën sipas emertimit shtesa për të zgjedhurit dhe nuk janë procesuar përmes listës së pagave dhe nuk kemi patur asnjë saqrim për këto kërkesa nga Thesari.

Ne si Komunë në silësin e Organizatës Buxhetore kemi kërkuar sqarime nga Thesari, i cili ka njoftuar se nuk është kompetent për dhënien e interpretimeve ligjore dhe nuk ka ofruar asnjë rekomandim se si të bëhet forma e pagesës dhe na janë ofruar opinionet ligjore për të cilat kemi qenë të njoftuar dhe opinionin ligjor për Komitetin për Komunitete në një paragraf thuhet kështu: "Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. Rrjedhimisht, për persona që nuk janë të punësuar në sektorin publik, zbatohet legjislacioni tjetër relevant në fuqi". Për më tepër, mosshlyerja e këtyre obligimeve mund të rezultojë në iniciimin e procedurave gjyqësore dhe përmbarimore ndaj Komunës, duke shkaktuar kosto shtesë në formën e shpenzimeve procedurale, interesit ligjor, shpenzimeve të përfaqësimit dhe përmbarimit, të cilat do të ishin dukshëm më të larta se realizimi i kompensimit në mënyrë vullnetare dhe në kohë.

Për këto arsye, duke qenë se legjislacioni në fuqi nuk përcakton klasifikim të veçantë ekonomik për realizimin e kompensimit të anëtarëve të jashtëm të Komitetit për Komunitete, ndërsa organet kompetente niveli qëndror Thesari dhe DMZP (MPB) nuk kanë ofruar interpretim detyrues lidhur me mënyrën e ekzekutimit të këtyre pagesave, Komuna, me qëllim të përmblotjes së obligimeve që rrjedhin nga ushtrimi i funksionit publik dhe mbrojtjes së interesit financiar të saj dhe shmangies së kostove shtesë që mund të rëndojnë buxhetin komunal, autorizon realizimin e kompensimit nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime që vlerësohet më e përshtatshme sipas klasifikimit ekonomik 13445 në kuadër të programve të Administratës Komunale duke përfshirë Arsimin dhe Shëndetësin. Paga bëhet në shumën bruto prej 207.90€, që korrespondon me 30% të pagës bazë të anëtarit të Kuvendit Komunal të Komunës së Mamushës, ndërsa ekzekutimi përmes Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike (SIMFK) realizohet sipas llogaritjes ligjore të tatimeve dhe kontributeve, në shumën neto 197.50€.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. NJMBNJ;
2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim-Mamushë;
3. Palëve;
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 166 /26
Me 06.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika (g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 26 dhe 27 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutit të Komunës së Mamushës datë 01.12.2008, si dhe në bazë të Kontratës së Grantit të Bashkimit Evropian – Veprimet e Jashtme nr. 2026/490-184, e lidhur ndërmjet Komisionit Evropian dhe përfituesve (Komuna e Mamushës si koordinator, Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit, Komuna e Bogovinjes dhe SHUKOS) dhe nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit kontaktues dhe përgjegjës për koordinim në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “BNS – BIO NATURAL SOLUTION”

Neni 1

Caktohet z. Engin Taç, Zyrtar i Lartë për Financa në Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Mamushës, si person kontaktues dhe përgjegjës për koordinim financiar, administrativ dhe komunikim në kuadër të zbatimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “BNS – BIO NATURAL SOLUTION” për menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbrojtjen e ujit në Komunitet e Mamushës dhe Bogovinjes”, nr. 2026/490-184.

Neni 2

Zyrtari i caktuar sipas nenit 1 të këtij vendimi obligohet që të: sigurojë komunikim zyrtar dhe të vazhdueshëm me menaxherin e projektit i autorizuar në përputhje me Kontratën e Grantit të Bashkimit Evropian nr. 2026/490-184 z.Hysni Ahmeti. Zyrtari kontaktues duhet të koordinojë pranimin, verifikimin dhe administrimin e faturave dhe dokumentacionit financiar të projektit, të sigurojë komunikim dhe bashkërendim me të gjithë partnerët e projektit sipas kërkesave të zbatimit, të garantojë qarkullimin e rregullt të dokumentacionit financiar dhe administrativ në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian dhe procedurat e brendshme komunale, të mbështesë procesin e raportimit financiar dhe administrativ të projektit.

Menaxheri i Projektit z.Hysni Ahmeti obligohet që, për çdo pagesë dhe aktivitet financiar të projektit, të përgatisë raport të strukturuar sipas modelit zyrtar të Komunës së Mamushës, i cili duhet të përmbajë: numrin e zotimit buxhetor, bllokun kodues, përfituesin, qëllimin e pagesës dhe dokumentacionin mbështetës përkatës në përputhje me kontratën e grantit dhe shtojcat përkatëse.

Neni 3

Zbatimi i këtij vendimi bëhet në përputhje me dispozitat e Kontratës së Grantit të Bashkimit Evropian nr. 2026/490-184, kushtet kontraktuale dhe rregullat financiare të Bashkimit Evropian, si dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore përkatëse që

rregullojnë menaxhimin e financave publike, ekzekutimin e buxhetit dhe administrimin e fondeve publike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike, z. Engin Taç në cilësinë e personit kontaktues dhe z.Hysni Ahmeti në cilësinë e Menaxherit të Projektit, i autorizuar në përputhje me Kontratën e Grantit të Bashkimit Evropian nr. 2026/490-184.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohet :

- z. Engin Taç, Zyrtar i Lartë për Financa – Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- z. Hysni Ahmeti, Menaxher i Projektit BNS;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar;
- Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Komunitetit (IC4CD);
- Komuna e Bogovinjes;
- SHUKOS – Shoqata e Ujit dhe Mbeturinave të Kosovës;
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 165/26
Me 06.07.2026
Mamushë



Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 26 dhe 27 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar nga AgroDev Kosovo (Fondacioni për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës) dhe Kryetari i Komunës së Mamushës sipas protokollit 02 Nr.23-26 datë 21.05.2026 dhe nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Menaxher i projektit bashkëfinancim me Fondacionin për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës-Agrodev Kosovo

- I. Caktohet z.Skender Şala, Udhëheqës i sektorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithëshme, caktohet Menaxher i projektit në bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes të Komunës së Mamushës dhe me Fondacionin për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës-Agrodev Kosovo sipas marrëveshjes së nënshkruar me datë 21.05.2026 02Nr.023-26.
- II. Menaxheri i kësaj marrëveshje obligohet të bashkëpunojë me bashkëfinancuesin me Fondacionin për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës-Agrodev Kosovo në të gjitha fazat deri në finalizim të projektit dhe i cili duhet të paraqesë një raport para çdo pagese.
- III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Bujqësisë
- Fondacioni për Zhvillimin Bujqësor të Kosovës-Agrodev Kosovo
- z Skender Şala
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 169-26
Me 02/07-2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim për Zyre”

1. **Z. Yahya Şala** Drejtor i Administratës së Përgjithshme, dhe **z. Buyar Mazrek** Drejtor i Arsimit Caktohen persona përgjegjës nga njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit **“Furnizim për Zyre”**
2. Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
3. **Obligohen-** personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
 - 3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzoj Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzoj specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 163/26
Me 02-07/26
Mamushë

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës merrë këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për monitorimin e fushatës korrje – shirje për vitin 2026 në komunën e Mamushës

Neni 1

Formohet komisioni për monitorimin e fushatës së korrje-shirjeve të drithërave për vitin 2026 në Komunën e Mamushës, në përbërje si më poshtë:

1. **Labinot Muhaxheri**– Kryesues i komisionit
2. **Rahman Morina** – Anëtar
3. **Erdinç Morina** – Anëtar

Neni 2

Komisioni ka për detyrë monitorimin, organizimin dhe menaxhimin e ecures së procesit të korrje-shirjeve, në bashkëpunim të ngushtë me fermerët dhe pronarët e autokombajnave.

Neni 3

Komisioni obligohet që të gjitha detyrat t’i realizojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Komisioni i përmendur në nenin 1 të këtij vendimi fillon punën menjëherë dhe vazhdon deri në përfundimin e sezonës së korrje-shirjeve për vitin 2026.

Neni 5

Komisioni është i obliguar të raportojë një herë në javë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Komisionin Qendror për Monitorimin e Korrje-Shirjeve, si dhe të hartojë raport të rregullt me shkrim për Kryetarin e Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komuna e Mamushës, si zonë me aktivitet të theksuar bujqësor, çdo vit zhvillon fushata intensive të korrje-shirjes së kulturave të drithit. Për të siguruar një proces të koordinuar, të sigurt, efikas dhe me ndikim sa më pozitiv për fermerët lokalë, është e domosdoshme formimi i një komisioni mbikëqyrës.

Ky komision do të ndihmojë në organizimin praktik të korrje-shirjeve, në komunikimin me pronarët e autokombajnave, si dhe në zgjidhjen e çështjeve teknike dhe logjistike që mund të paraqiten gjatë sezonës.

Gjithashtu, raportimi i rregullt ndaj instancave qendrore dhe komunale garanton transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit bujqësor. Vendimi bazohet në nevojat reale të terrenit dhe është në përputhje me ligjet dhe politikat bujqësore në fuqi.

Me këtë vendim njoftohet :

- Anëtarët e Komisionit,
- Drejtoria komunale për Bujqësi dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 162 /26
Me 02.07.2026
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushë 01/2008 të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

z. Nesim Mazrek me numër personal: [REDACTED], i cila sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës gjegjësisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me titull të pozitës Vozitës i Autoambulantës është përzgjedhur si fitues i konkursit në fjalë dhe me datën 02.07.2026 ka nënshkruar Kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr.94/26 e datës 02.07.2026, me titull të pozitës Vozitës i Autoambulantës, kategoria Nëpunës teknik dhe mbështetës, klasa GJ50 koeficienti 4.80.

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MF), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të Kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr.94/26 e datës 02.07.2026.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- NJMBNJ
- Sistemi i Pagave – Thesar (MF)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 161 -26
Datë: 01-07 /2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me Ligjin nr. 03/L-212 të Punës, Vendimit për shqipimin e mases disiplinore të komisionit disiplinor me numër te protokollit 02.Nr. 34/26 e datës 31.03.2026 dhe nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për përfundimin e Ndalimit të pagës në bazë të Vendimit për shqipimin e mases disiplinore të komisionit disiplinor me numër te protokollit 02.Nr. 34/26 e datës 31.03.2026

- I. Z. Muhammed Bitiçi mësimdhënës i Edukatës Fizike në SH.F.M.U ANADOLU i përfundon masa disiplinore i shqiptuar në bazë të Vendimit për shqipimin e mases disiplinore të komisionit disiplinor me numër te protokollit 02.Nr. 34/26 e datës 31.03.2026
- II. **Obligohet** Drejtoria Komunale e Arsimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë realizimin e përfundimit të masës disiplinore, dhe për të njëjtin ta përgadit formularin për pagën e plotë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Muhammed Bitiçi mësimdhënës i Edukatës Fizike në SH.F.M.U ANADOLU në Mamushë iu është shqiptaru masë disiplinore nga Komisioni Disiplinor për shkak të shkeljeve të rënda në vendin punës

Komisioni Disiplinor me anë të vendimit me numër të Protokollit 02.Nr.34-26 të datës 31.3.2026 ka marr vendim për shqiptimin e masës disiplinore në bazë të Ligjit për zyrtar publik Nr.08/L-197 dhe legjislacionit në fuqi duke i dhënë një masë ndales në pagë prej 20% për 3 muaj, shuma e cila do të ndalet në pagë prej 3 muajsh është 145.2€.

Me datën 30.06.2026 të njëjtit i ka pëfunduar masa disiplinore i shqiptuar nga Komisioni Disiplinor, andaj nga data 01.07.2026 i njëjti duhet të paguhet me pagë të plotë.

Andaj, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi

Njoftohen

- DKA
- Thesari-MF
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 160 /26
Me 01.07.2026
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushë 01/2008 të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

z. Çamil Mazrek me numër personal: [redacted] i cila sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës gjegjësisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me titull të pozitës Vozitës i Autoambulantës është përzgjedhur si fitues i konkursit në fjalë dhe me datën 01.07.2026 ka nënshkruar Kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr.93/26 e datës 01.07.2026, me titull të pozitës Vozitës i Autoambulantës, kategoria Nëpunës teknik dhe mbështetës, klasa GJ50 koeficienti 4.80.

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MF), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të Kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr.93/26 e datës 01.07.2026.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- NJMBNJ
- Sistemi i Pagave – Thesar (MF)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 159/26

Me 01-07/26

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenet 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 dhe 87 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës dhe lidhur me vendimin 02.Nr.156/26 të datës 26.06.2025, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1

Në bazë të vendimit nr. 02.Nr.156/26 të datës 26.06.2025, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, të z. Guxim Bytyçi, largohet nga lista e pagave nga data 01.07.2026, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Mamushë, nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin e z. Guxim Bytyçi nga lista e pagave dhe përditësimin e të dhënave në sistemin administrativ përkatës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.07.2026 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

z. Guxim Bytyçi, i sistemuar në pozitën Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, ka paraqitur dorëheqjen e tij me vullnet të lirë, e cila është pranuar me vendimin nr. 02.Nr.156/26, të datës 26.06.2026. Në përputhje me këtë vendim, marrëdhënia e tij e punës ndërpritet me datë 01.07.2027.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe në rregulloret përkatëse për administrimin e listës së pagave, z. Guxim Bytyçi duhet të largohet nga lista e pagës, duke reflektuar gjendjen reale të marrëdhënies së saj të punës.

Njoftohen

1. DSHMS.
2. Thesari
3. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasnić





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 158/26

Me 01-07-2026

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për pagesën retroaktive

- I. Z. Raif Mazrek, në bazë të Kontratës së Punës me nr. 02.Nr.61/26, të datës 18.05.2026 është përzgjedhur Drejtor i Sh.F.M.U ANADOLU.
- II. Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që ta dërgojë dokumentacionin përkatës tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MF), me qëllim të realizimit të pagesës retroaktive për diferencën e pagës për periudhën 01.06.2026 deri 30.06.2026, në shumën e përgjithshme prej 447 €.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Raif Mazrek, në bazë të Kontratës së Punës me nr. 02.Nr.61/26, të datës 18.05.2026 është përzgjedhur Drejtor i Sh.F.M.U ANADOLU. Në përputhje me këtë vendim, Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndërmarrë me kohë të gjitha veprimet e nevojshme dhe ka dërguar ndryshimet përkatëse në listën e pagave, por për të njëjtin nuk është llogaritur me ore të punës 40 orë por të njëjtit gabimisht iu është llogaritur 20 orë në javë.

Në bazë të legjislacionit në fuqi për pagat në sektorin publik dhe duke u mbështetur në Kontratën e punës, është krijuar obligimi ligjor për kompensimin e diferencës së pagës për periudhën 01.06.2026 deri 30.06.2026.

Andaj, përmes këtij vendimi kërkohet që Thesari i Kosovës – Ministria e Financave të realizojë pagesën retroaktive në shumën prej 447.48 €.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MF)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 157/26
Me 01.07.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/1-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për pagesën retroaktive

- I. Z. Mehmet Morina, me Vendimin nr. 02.Nr.46/26, të datës 02.03.2026 është caktuar Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë së Prokurimit Publik.
- II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) që ta dërgojë dokumentacionin përkatës tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MF), me qëllim të realizimit të pagesës retroaktive për diferencën e pagës për periudhën 02.03.2026 deri 29.05.2026, në shumën e përgjithshme prej 550.85 €.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Mehmet Morina është caktuar Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë së Prokurimit Publik me Vendimin nr. protokolli 02.Nr.46/26, të datës 02.03.2026. Në përputhje me këtë vendim, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) ka ndërmarrë me kohë të gjitha veprimet e nevojshme dhe ka dërguar ndryshimet përkatëse në listën e pagave.

Megjithatë, pavarësisht dërgimit me kohë të këtyre ndryshimeve, ato nuk janë procesuar nga Thesari i Kosovës, duke rezultuar në mosrealizimin e plotë të pagesës sipas pozitës përkatëse.

Në bazë të legjislacionit në fuqi për pagat në sektorin publik dhe duke u mbështetur në vendimin për caktimin në detyrë, është krijuar obligimi ligjor për kompensimin e diferencës së pagës për periudhën 02.03.2026 deri 29.05.2026.

Andaj, përmes këtij vendimi kërkohet që Thesari i Kosovës – Ministria e Financave të realizojë pagesën retroaktive në shumën prej 550.85 €.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MF)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç